



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2024, ora 12:00

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE VIII

Drejton tryezën: Nadia Rusi

Rendi i ditës:

Garantimi i së drejtës së pronës

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Klotilda Bushka, Toni Gogu dhe Elda Zenelaj.

Të ftuar:

Nadia Rusi, Nada Dollani, Eda Noçka, Edi Rama, Mirsada Hallunaj, Jonida Rystemaj, Reald Keta, Kozeta Pinari, Elvira Gjikonci, Suela Ago, Sonja Sinorakaj, Teisa Kurti, Besa Velaj, Ermal Qovi, Ergys Gjençaj, Fjorela Beleshi, Greta Bullari, Raziela Myslimaj, Monika Canco, Anxhela Bakiasi, Marsel Llukmani, Brunilda Kostare, Adriana Ristani, Stela Suloti, Lorena Goxhobelli, Giulia Re, Isabele Thomas Delic, Valbona Legisi, Aida Hoxham Davis Backman, Reinaldo Pipiria, Erjon Harizi, Juljan Hysomema, Ilda Melaj, Artan Hoxha, Spiro Brumbulli, Albina Husanaj, Doreda Kafexhiu, Erina Caka, Dritan Jalaj, Blerina Pirani, Insidor Rexhepi, Athanasios Kartelis, Erion Çako, Fiona Tako, Luan Veliqoti, Arbian Mazniku, Odeta Berberi, Majlinda Dhuka, Aldo Merkoci, Elona Saliaj, Ilda Zaloshnja, Ilir Simaku, Eva Bico, Rovenë Pregja, Piro Lutaj, Bjanka Duka, Sabiela Seitaj, Enkelejda Daja, Andi Proko, Jorida Dedej, Jonida Brati, Kejsi Ziu, Ernis Xhelila, Silvana Ramadani, Eva Dyrmishi, Majlinda Thomaj, Adela Tagani, Ardian Kamenica dhe Artan Kotro.

HAPET MBLEDHJA

Nadia Rusi – I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar anëtarë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të organizatave ndërkombëtare,

Të nderuar kolegë, ekspertë,

Kam kënaqësinë sot t'ju uroj mirëseardhjen në këtë tryezë teknike diskutimi në lidhje me një çështje mjaft të rëndësishme: garantimi i së drejtës së pronës dhe lufta kundër korrupsionit në Shqipëri.

Kjo është një nga 12 tryezat teknike të diskutimit që kemi pasur në lidhje me dokumentin analitik të përgatitur në kuadër të komisionit të posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

Sot kemi privilegjin të mblidhemi të gjithë së bashku në këtë sallë, për të adresuar një nga çështjet më të ndjeshme dhe më problematike për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë, ku ligjshmëria, transparenca dhe drejtësia ndërthuren për të ndikuar drejtpërsëdrejti në jetën e të gjithë qytetarëve dhe individëve.

Të drejtat e pronës nuk janë vetëm çështje teknike, nuk janë vetëm çështje ligjore, nuk janë vetëm çështje që prekin agjencitë zbatuese, por, gjithashtu, janë çështje të ligjvënës, të grupeve të interesit, të biznesit, të sipërmarrësve, në mënyrë që të kemi një sistem të qëndrueshëm, që garanton të drejtat e pronës. Çdo qytetar, investitor, sipërmarrës, kërkon siguri për pronën, si një garanci për të ardhmen. Në këtë kontekst, le ta përdorim këtë tryezë sot si një mundësi unike për të ndarë mendimet, për të diskutuar në lidhje me sfidat që adresojnë sistemin pronësor në Shqipëri dhe, gjithashtu, për të propozuar mbase zgjidhje konkrete, në mënyrë që të mund të garantohet e drejta e pronës për çdo individ.

Më lejoni ta nis diskutimin sot me një pikturë, që ju e keni të gjithë përpara dhe që, në fakt, flet për misionin tonë. Jeta jonë është e mbushur me simbole, dhe në këtë rast “Fusha me grurë dhe korba” e Van Gogut tregon pikërisht problematikat dhe sfidat që paraqiten në kontekstin e sistemit pronësor në Republikën e Shqipërisë. Sfida jonë sot është që të hapim atë qiellin e errët në pikturën përballë dhe të mund të diskutojmë të gjithë së bashku për mënyrën se si mund t'i

adresojmë sfidat me të cilat përballen sistemi pronësor dhe të drejtat e pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Diskutimi në tryezën e sotme do të bazohet në dokumentin analitik të përgatitur nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, në kontekstin e shtyllës së tretë, të sundimit të ligjit, dhe njëkohësisht edhe në kuadër të shtyllës mbi antikorrupsionin për sa i përket komponentit të dytë, të cilin ne do ta diskutojmë në tryezën e sotme.

Materiali që do të prezantojmë është vetëm një material paraprak, që të gjithë keni pasur mundësi ta konsultoni në faqen e *web-it*, të komisionit të posaçëm parlamentar, i aksesueshëm që nga momenti kur është finalizuar si draft i parë, dhe sot, me diskutimet dhe kontributin e secilit prej jush, do të kemi mundësi të përmirësojmë jo vetëm përmbajtjen e këtij materiali, por gjithashtu edhe të adresojmë çështje të ndjeshme në lidhje me të.

Në fakt, kjo nuk është tryeza e parë në të cilën kemi pasur mundësi të diskutojmë për çështjet që prekin reformën për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin. Në tryezën e kaluar, më lejoni t'ju kujtoj, ne përmendëm një nga rastet që prekte çështjen e së drejtës së pronësisë. Familja Hoxha, jo shumë larg nga Tirana, që kishte pothuajse 30 vjet duke luftuar për të siguruar pronësinë e një toke të trashëguar ndër breza, megjithëse zotëronte dokumente ligjore, u përball me pretendime të mbivendosura, me probleme të pazgjidhura regjistrimi, si dhe me çështje të tjera, që e mbajtën peng këtë familje për më shumë se tri dekada. Babai, dikur një fermer krenar, ndërroi jetë pa gjetur zgjidhje, duke e trashëguar çështjen e pronësisë pikërisht te fëmijët e tij. Ky nuk është një rast i izoluar në realitetin tonë, është realiteti me të cilin përballen mijëra familje shqiptare dhe përpjekjet e tyre na bëjnë të kujtojmë sot, që të drejtat pronësore nuk kanë të bëjnë vetëm me dokumentet ligjore, të drejtat pronësore kanë të bëjnë me jetën e njerëzve, me ëndrrat, me dinjitetin e tyre. Thënë këtë, do të doja t'ju kujtoja se pse e kemi parë këtë si një tryezë e cila meritonte një vëmendje të veçantë, në kontekstin e veçimit të të gjitha të drejtave që i kemi analizuar në dokumentin analitik.

Në kuadër të çështjeve që do të diskutojmë sot, në aspektin organizativ tryeza është e ndarë në dy diskutime kryesore: në pjesën e parë do të diskutohen gjetjet në lidhje me analizën për garantimin e të drejtave të pronësisë, si një e drejtë themelore për sa u përket të gjithë individëve, dhe në pjesën e dytë diskutimi do të fokusohet në analizën sa i përket luftës kundër korrupsionit në një nga sektorët e identifikuar me risk të lartë korrupsioni, siç është sektori i pronave në Shqipëri.

Në kontekstin e rëndësisë që ka e drejta pronësore është konsideruar si një nga të drejtat më të rëndësishme, parashikuar qoftë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030, ashtu edhe në programin qeverisës dhe në dy dokumentet me të rëndësishme në rrugëtimin që ne kemi nisur drejt Bashkimit Europian, në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2030, si dhe në Agjendën e Reformës 2030. Në këtë kontekst, në analizën që ne kemi përgatitur, u jemi referuar dhe kemi marrë për bazë kryesisht dokumentet që adresojnë çështjet dhe shqetësimet që ngrenë organizmat ndërkombëtarë, Komisioni Europian, qoftë në progresraportet e përvitshme ndaj shtetit shqiptar, qoftë në raportin “Për sundimin e ligjit 2024”, ashtu edhe në raportin *screening* për Shqipërinë, në mënyrë që të evidentojmë se cilat janë ato, por pa harruar edhe instrumente të tjera apo dokumente të tjera të rëndësishme, qoftë në kuadër të indekseve ndërkombëtare mbi të drejtën e pronës, qoftë të institucioneve të tjera, të cilat ne i kemi pasur edhe pjesë të grupeve të punës, në kontekstin e analizës së këtij dokumenti analitik.

E drejta pronësore është një nga të drejtat kryesore, e cila prek si zhvillimin ekonomik, ashtu edhe stabilitetin social në vend, dhe njëkohësisht është një nga elementet kryesore që ndikon në investimet që mund të bëhen brenda Republikës së Shqipërisë nga të gjitha grupet e interesit, nga sipërmarrësit apo investitorët e tjerë.

Nëse i referohemi rrugëtimit që ka pasur procesi, ka qenë një proces i cili, në kontekstin e sistemit tonë ligjor, është përballur me ndryshime të herëpashershme, madje do t’i konsideronim si ndryshime shumë të shpeshta, të cilat duket sikur e morën drejtimin e tyre pikërisht në kontekstin e fillimit të reformës për menaxhimin e integruar të tokës nga viti 2017 e në vazhdim.

Edhe nëse u referohemi raportprogreseve të Komisionit Europian, theksohet se Shqipëria ka bërë përparime të dukshme në fushën e të drejtave të pronës, duke ndjekur një agjendë reformash që synon përmirësimin e kuadrit ligjor dhe administrativ të pronësisë.

Miratimi i legjislacionit të rëndësishëm, si ligji nr.111 në vitin 2018 dhe ligji nr.20 në vitin 2020, që kanë qenë dy kuadro ligjorë kyç, në fakt, krijuan dhe ndryshime të rëndësishme në mënyrën e administrimit, të menaxhimit të sistemit të pronave në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu, krijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke unifikuar në një trup të vetëm tashmë një sërë procesesh, të cilat kanë qenë të vendosura në institucione të ndryshme më herët, si dhe, në kontekstin e një ndryshimi tjetër të rëndësishëm, që vlen të theksohet edhe për efekt të analizës, duke filluar nga viti 2020 ne kemi një sistem *online* të ofrimit të shërbimeve në kuadër të të drejtave pronësore.

Në vitin 2022 është ngritur Qendra e Kadastrës Digjitale, e cila në progresraportet e viteve 2023-2024 është konsideruar si një nga mekanizmat dhe një nga risitë për sa i përket reformës në digjitalizimin e hartave dhe titujve të pronësisë.

Megjithatë, edhe duke i marrë në konsideratë të gjitha këto ndryshime, përsëri Shqipëria përballet me sfida sa u përket çështjeve të së drejtës së pronësisë. Rezultatet e dhëna nga Indeksi Ndërkombëtar për të Drejtat e Pronësisë në vitin 2023 tregojnë se Shqipëria renditet në vendin e 82-të nga 125 vende të botës, duke e vlerësuar me një performancë mesatare për të drejtat e pronës fizike dhe duke pasur nevojë për përmirësime.

Nga ana tjetër, Departamenti Amerikan i Shtetit, në deklaratat e tij vjetore për klimën e investimeve, thekson se, pavarësisht përmirësimeve që janë bërë në sistemin e regjistrimit, të dhënat e paplota mbeten një rrezik për sigurinë e titujve dhe një pengesë për investimet.

Një nga problemet kryesore që lidhet me çështjet e pronësisë ka të bëjë pikërisht me mbivendosjet e pronave në regjistrat kadastralë. Ky fenomen është shkaktuar nga regjistrimet e pasakta të së kaluarës dhe mungesa e standardizimit, duke krijuar konflikte të vazhdueshme në kontekstin e çështjeve pronësore, si dhe vonesa për sa i përket ekzekutimit të vendimeve.

Gjithashtu, një çështje tjetër, që ne e kemi evidentuar në kontekstin e sfidave dhe problematikave të sistemit të pronësisë, ka të bëjë me saktësinë e të dhënave. Ne konstatojmë sot se rreth 80% e të dhënave kadastrale janë të pasakta, të njohura këto edhe nga institucionet ndërkombëtare, gjë që, patjetër, ndikon negativisht në ekzekutimin e vendimeve për kompensim dhe në regjistrimin e pronave. Në të njëjtën kohë, ka shumë raste gjyqësore, pra qoftë çështjet e mbivendosjeve, qoftë saktësia ndikojnë dhe patjetër që sjellin impakt për sa u përket proceseve gjyqësore, dhe një ndër problemet që ne kemi evidentuar në kontekstin e këtij dokumenti analitik lidhet pikërisht me proceset e rregullta ligjore dhe respektimin e afateve të arsyeshme për sa i përket zgjidhjes së çështjeve pronësore. Edhe në kuadër të reformës në drejtësi dhe të të gjitha çështjeve të cilat janë të lidhura me *backlog*-un në sistemin gjyqësor, problematikat në lidhje me afatet dhe procesin e rregullt ligjor janë problematika që shoqërojnë dhe ndikojnë në mënyrë të ndjeshme edhe për sa u përket vendimeve gjyqësore apo çështjeve të hapura në kontekstin e të drejtave pronësore.

Të gjitha kufizimet për sa i përket pronës private do të duhet patjetër që të zbatohen në përputhje me standardet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Shqipëria do të duhet

t'i përfundojë proceset kalimtare të regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Ne e përmendëm që në fillim që është bërë një punë mjaft e madhe dhe njëkohësisht janë konsideruar si arritje përmirësimet e kuadrit ligjor. Megjithatë, edhe në kontekstin e raporteve të progresit, sërish theksi vihet te miratimi i akteve me karakter nënligjor, në referencë të zbatimit të të dyja ligjeve kryesore, qoftë ligjit për kadastrën, qoftë ligjit për përfundimin e proceseve tranzitore, sidomos në rëndësinë që ka përfundimi dhe finalizimi i aktit nënligjor në lidhje me metodologjinë për hartën e vlerës së tokës, si një nga çështjet më të rëndësishme dhe, gjithashtu, në kontekstin e bashkëpunimit midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave, vendimi i Këshillit të Ministrave, i cili rregullon marrëdhënie midis këtyre dy institucioneve, si hallka të rëndësishme të procesit në të drejtat pronësore.

Një çështje tjetër, e cila vihet në konsideratë në kuadër të analizës, është rëndësia e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për numrin e madh të çështjeve, për proceset gjyqësore të Shqipërisë përpara Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ku pjesën më të madhe të rasteve në Strasburg shteti shqiptar e ka në kontekstin e nenit 1, protokollit nr.1, që është “E drejta për garantimin e pronës private”. Nga ana tjetër, kemi një numër të konsiderueshëm vendimesh, të cilat, edhe pse janë dhënë nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, janë ende në procesin e vendimeve të pazbatuara, në kuadër të respektimit të drejtës së pronës për shtetasit shqiptarë.

Siç e përmenda, një nga çështjet, të cilat ne e kemi prekur në dokumentin analitik, të cilin ju e keni konsultuar, lidhet edhe me pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore, qoftë në kontekstin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, qoftë në kontekstin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave për sa i përket përmbylljes së detyrimeve brenda afateve kohore të vendosura në kuadrin ligjor në fuqi.

Viti 2028 nuk është edhe aq larg, por, nëse ne i referohemi Agjencisë së Trajtimit të Pronave, kemi një afat shumë më të afërt, që përfundon në dhjetor të këtij viti. Në kuadër të njohjes dhe kompensimit të pronave, unë do të doja që të mund të theksoja vetëm disa elemente të rëndësishme, të cilat janë theksuar në dokumentin analitik: 7 mijë kërkesa për kompensim, të pashqyrtuara ende nga Agjencia e Trajtimit të Pronave; mbi 4 mijë vendime, të cilat janë të prekura nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe më pak se 800 vendime të zbatuara, njëkohësisht, një afat shumë të afërt që unë sapo e përmenda.

Elementi tjetër, i cili ka qenë në fokus të analizës dhe lidhet pikërisht me proceset tranzitore, kalimtare të pronësisë, ka të bëjë pikërisht me problematikat në sistemin e pronësisë, në çështje apo në terma të procesit të legalizimeve, i cili, në kuadër të analizës dhe shqyrtimit të Komisionit European, është konsideruar si një proces që ka ecur me ritme të ngadalta, duke marrë në konsideratë që pothuajse në më shumë se 5 vjet ne kemi vetëm 2,9% në vit të shqyrtuara, në kontekstin e kërkesave për legalizim, i cili përsëri është një proces që afatin fundor e ka në vitin 2028. Në këtë kuadër, duke marrë në konsideratë të gjitha këto çështje, të cilat janë të prekura në dokumentin analitik, në termat e nevojës për ndërhyrje ne kemi identifikuar disa elemente, të cilat mundet të bëhen edhe objekt i diskutimit të tryezës së sotme. Çështjet, të cilat në kontekstin dhe në vlerësimin e grupit të ekspertëve kanë nevojë të merren në konsideratë në kuadër të kësaj reforme, lidhen: së pari me korrigjimin dhe nevojën për korrigjim dhe përmirësimin e të dhënave kadastrale, duke propozuar se cilat mund të jenë masat dhe nevojat për të ndërhyrë në këtë proces; ndërhyrje, të cilat mundet të prekin digjitalizimin e regjistrave të pronës, gjithashtu digjitalizimin e hartave; nevojën për miratimin e një politike të tokës, në kuadër edhe të reformës për agjendën qeveritare; ndërhyrje në kontekstin e lehtësimit të proceseve të aplikimit për sa i përket regjistrimit të titujve të pronësisë dhe të gjitha proceseve, të cilat janë të lidhura me to, gjithashtu, të nevojës për ndërhyrje në kuadër të garantimit, të zbatimit të vendimeve gjyqësore që prekin çështjet e pronësisë. Secila nga këto normalisht do të duhet që të bëhet vetëm nëse kemi një koordinim të të gjithë aktorëve.

Pra, nëse ju shikoni se si mundet që ne të kemi një ndërveprim për këtë çështje, do të duhet që të kemi të gjithë aktorët së bashku: Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Agjencinë e Trajtimit të Pronave, sistemin gjyqësor, pushtetin lokal, nga ana tjetër sistemin apo AKSHI-n përmes “e-Albania”-s dhe sistemin e noterisë, të cilët mund të bëjnë që të koordinohet procesi dhe të mund t’i funksionojnë çështjet në lidhje me të drejtën e pronësisë.

Në fund, do t’ju lutesha që të kishim në vëmendje disa nga çështjet që ne kemi individualizuar si teza të mundshme për diskutim, për të cilat do të donim që të merrnim normalisht mendimet dhe sugjerimet tuaja.

Së pari, cilat janë pengesat kryesore që ju mendonin se vonojnë përfundimin e procesit të regjistrimit të pronave në vendin tonë? Si mund të përshpejtohet procesi i digjitalizimit të të dhënave kadastrale dhe a kemi mjaftueshëm burime për ta përmbushur këtë detyrë? A është krijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës një zgjidhje e qëndrueshme, në kontekstin e kësaj reforme të

sistemit të pronësisë? A janë ndryshimet ligjore të mjaftueshme, për të garantuar përfundimin e regjistrimit të pronave dhe procedurave të kompensimit brenda afateve të përcaktuara?

Këto janë vetëm disa nga çështjet, të cilat ne i kemi individualizuar. Kështu që, në diskutimet tuaja mund të prekni edhe çështje të tjera, të cilat, ndoshta, nuk kanë qenë në vëmendjen tonë, edhe për efekte të identifikimit të elementeve, që do të donim të ndanim në kontekstin e dokumentit analitik.

Pa dashur të zgjatem më tej, do t'ia kaloj menjëherë fjalën koleges sime, Nada Dollani, e cila do të ndajë me ju gjetjet e analizës së grupit të ekspertëve të nivelit të lartë në fushën e dytë, antikorrupsioni, për sa u përket çështjeve të evidentuara në dokumentin analitik në lidhje me antikorrupsionin.

Fjala për ju, Nada.

Nada Dollani – Shumë faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

I nderuar zoti Kryeministër,

Ne të gjithë dëgjuam rëndësinë e madhe që ka e drejta e pronësisë në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, ku do të ndalem shkurtimisht, duke qenë se është një sektor kaq i rëndësishëm, jashtëzakonisht vulnerabël dhe i ndjeshëm ndaj korrupsionit. Kështu që, në fjalën time të shkurtër do të ndalem vetëm në disa masa që ne kemi propozuar kundër korrupsionit, pra se si mundet që të eliminohet apo të parandalohet korrupsioni.

Kolegia ime përmendi shumë nga raportet dhe rëndësinë që kishin apo problematikat që kishte sektori i pronave në Shqipëri. Raportet e Komisionit Europian kanë identifikuar, ndërmjet sektorëve të tjerë, edhe sektorin e pronave, si një nga sektorët shumë të ndjeshëm ndaj korrupsionit. Cila është nevoja kryesore në këtë fushë?! Është kryerja e vlerësimeve të posaçme të rrezikut në sektorët vulnerabël dhe ndërmarrja e veprimeve të posaçme me masa integriteti për të forcuar Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Problematikat kanë qenë të vazhdueshme, pavarësisht se janë marrë masa, gjithsesi, problemet vazhdojnë të ekzistojnë dhe është e nevojshme një ndërhyrje, me qëllim që zbatimi i këtyre masave të bëhet më efektiv.

Cilat janë masat që mund të merren për forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin e pronave?

Së pari, masa e parë që është identifikuar përkundrejt kësaj problematike, është për të forcuar integritetin në sektorin e pronave, ku kërkohet një strategji që përfshin vlerësimin e rrezikut

sektorial të korrupsionit; analizën e proceseve për t'i identifikuar dobësitë dhe zhvillimin e një plani të masave për zvogëlimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e kapaciteteve për integritet në sektorin e pronave përmes hartimit të një programi të posaçëm trajnimi për punonjësit e kadastrës dhe punonjësit e administratës publike në përgjithësi, që mund të jetë pjesë e planeve të integritetit, të cilat qeveria i ka parashikuar ndërkohë.

Masa e tretë është rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe e njohurive të tyre për mënyrat e denoncimit të korrupsionit.

Masa e katërt ka të bëjë me nxitjen e sinjalizimit, që është thelbësore për përmirësimin e këtij sistemi. Për të arritur këtë, duhet të rritet ndërgjegjësimi për ekzistencën dhe funksionimin e mekanizmave të sinjalizimit, duke garantuar anonimitet dhe siguri për të gjithë sinjalizuesit. Gjithashtu, çdo raportim apo sinjalizim duhet të pasohet nga veprime konkrete, me qëllim për të ndërtuar besim te sinjalizuesit.

Transparenca është një problematikë e rëndësishme në sektorin e pronave. Sipas raportit të Komisionit European për Shqipërinë, theksohet nevoja për përmirësimin e regjistrimit fillestar dhe kompensimit, duke rritur transparencën dhe cilësinë e të dhënave. Masa e rekomanduar në këtë aspekt është rritja e transparencës në sektorin e pronave, që është thelbësore për ndërtimin e besimit publik dhe përmirësimin e efikasitetit. Për të adresuar çështjet e transparencës, duhet të hartohet një strategji konkrete. Në raport me strategjinë konkrete, cilat mund të ishin disa nga pikat kyçe që mund të përfshiheshin në këtë strategji?

Së pari, është analiza e nevojave të qytetarëve, ku të përcaktohen qartë informacionet që qytetarët kërkojnë dhe një mënyrë më e mirë për t'i ofruar ata në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme.

Së dyti, mund të jetë përmirësimi i platformave *online*, që ka të bëjë me përditësimin e platformës “*e-Albania*” për t’u bërë më e thjeshtë dhe më e lehtë për t’u përdorur nga qytetarët.

Sigurimi që të gjitha shërbimet *online* të jenë plotësisht funksionale dhe të qarta. Gjithashtu, këtu duhet marrë në konsideratë edhe ai grup njerëzish, të cilët mund të mos kenë njohuri të mira digjitale apo mund të ndodhen në zona të ndryshme gjeografike, që nuk e kanë aksesin e duhur.

Një aspekt tjetër është integrimi i standardeve të larta të transparencës. Këtu një element i rëndësishëm është elementi i publicitetit për të drejtën e pronave, edhe këtu propozohet, por kjo është një çështje për diskutim, sikurse në vende shumë të njohura. Gjermania është vendi ku libri

apo regjistri i pronave është një nga më të mirët në botë, është unik. Ne atë nuk e arrijmë dot, por, të paktën të afrohem në standardet apo në parimet që ata mund të kenë, në raport me elementin e publicitetit.

Propozohet që të dhënat kadastrale të përfshihen në regjistrin e pronave të paluajtshme dhe të jenë të aksesueshme, si burim i hapur për çdo person apo qytetar që mund të ketë interes për këtë pronë, për të negociuar për këtë pronë, për ta blerë, për ta shitur e të tjera me radhë. Megjithatë, sigurisht që informacioni që përfshin emrat, datat e lindjes, adresat e pronarëve të pronave, bëhet i disponueshëm vetëm për individë apo subjekte që mund të kenë interes legjitim për t'i marrë këto të dhëna.

Digjitalizimi i shërbimeve është, gjithashtu, i rëndësishëm. Këtu është gjurmimi elektronik i regjistrimit, qartësimi i sistemit të gjurmimit elektronik, ku qytetarët mund të ndjekin se ku ndodhet dosja ose kërkesat e tyre në çdo moment të procesit. Çdo kërkesë duhet të ketë një kod unik, që mund të përdoret për të marrë informacione *online* ose përmes qendrave të shërbimit.

Cili do të ishte rezultati i këtyre lloj masave?! Është zbatimi. Do të përmirësonte transparencën; do të lehtësonte aksesin për qytetarët në informacion dhe do të rritë efikasitetin e ASHK-së, për të ndërtuar një sistem më të drejtë dhe më të besueshëm të administrimit të pronave.

Nevoja për burime njerëzore për të përfunduar proceset u evidentua edhe nga kolegja ime. Kështu që, te bashkëpunimi institucional dhe nevoja për burime financiare dhe të burimeve njerëzore nuk po ndalem, por po kaloj direkt tek tezat për diskutim.

Disa nga pyetjet që kanë lindur apo që mund t'ju nxisin edhe ju në pikëpamjen intelektuale për të dhënë disa sugjerime, është efektiviteti i planit të integritetit. Si mund të sigurohet që plani i integritetit të kadastrës të jetë një instrument i fortë për identifikimin e rreziqeve dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin e pronave?

Transparenca dhe llogaridhënia

Cilat masa konkrete mund të ndërmerren për të rritur transparencën e llogaridhënies në administrimin e pronave?

Mbrojta e sinjalizuesve

Ne e dimë që kemi një legjislacion për sinjalizuesit, por ai ka qenë shumë pak i zbatueshëm. Të dhënat statistikore nxjerrin në pah që ka pasur shumë pak raste të sinjalizuesve.

Roli i teknologjisë në parandalimin e korrupsionit. Më zhvillimet e sotme teknologjike dhe të inteligjencës artificiale, a mund të përdorim diçka për vlerësimin e riskut në sektorin e pronave? Si mund të realizohet monitorimi i performancës në institucione?

Faleminderit!

Nadia Rusi – Faleminderit, Nada, për prezantimin e gjetjeve edhe për sa u përket çështjeve që lidhen me diskutimet për masat antikorrupsion. Në më pak se 1 minutë Neil Armstrong tha që ky është një hap i vogël për njeriun dhe një hap i madh për njerëzimin. Ne do t'ju luteshim që ju të përdorni jo 1 minutë, por 3 minuta kohë në dispozicion për të ofruar të gjithë kontributin, sugjerimet dhe mendimet tuaja për secilën prej çështjeve të individualizuara nga ana jonë për diskutim, gjithashtu, edhe për çështjet e tjera, të cilat i mendoni me rëndësi për efekt të diskutimeve të kësaj tryeze.

E konsideroj të hapur dhe ftoj secilin prej jush të marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutim.

Luan Bregasi – Me leje.

Nadia Rusi – Patjetër.

Do t'ju lutesha vetëm një prezantim të shkurtër në fillim.

Luan Bregasi – Luan Bregasi, president i “Biznes Albania”.

Ne jemi në këtë komision dhe përfaqësohemi me dy specialistë, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm këtu. Duhet të themi që biznesi në përgjithësi dhe shoqata jonë e mbështesin këtë komision.

Edhe ne fillimisht ramë pre e një propagande se kjo po bëhet për të krijuar ekuilibra mes institucionit dhe ligjit, por nuk është e vërtetë. Kemi kuptuar nga dita në ditë dhe gati në çdo mbledhje se është një komision shumë i rëndësishëm për të përgatitur një projekt më dinjitoz për Shqipërinë 2030.

Lidhur me çështjet që po diskutojmë, unë kam dhënë disa mendime dhe në një takim tjetër, por, duke vlerësuar akoma më shumë çështjen e fokusit të pronat, pra, të sigurisë së pronës, e drejta e pronës, mendoj se është një nga temat më të rëndësishme që duhet të diskutojë komisioni i posaçëm për të përmirësuar dhe për të bërë rekomandimet e nevojshme, për t'u dhënë zgjidhje shumë problemeve që ne kemi vite që vuajmë dhe vazhdojmë të vuajmë.

E kam thënë edhe një herë tjetër, por, meqenëse është edhe Kryeministri këtu, po e them: në vitin 2014, kur erdhi kjo mazhorancë, Kryeministri ka thënë në një tavolinë të tillë me biznesin që nuk ka njerëz të korruptuar (kur foli për korrupsionin), por ka sisteme të korruptuara.

Në fakt, u çuditëm, se ne erdhëm nga një qeverisje me një ngarkesë të lartë korrupsioni të njerëzve dhe ne thamë “Kush është ky që thotë kështu? Nuk paska këtu njerëz të korruptuar?”. Por kjo ishte e vërtetë dhe sinqerisht e kam vlerësuar këtë çështje dhe e vlerësoj përsëri, sepse e gjithë paketa e masave që u mor më vonë për të përmirësuar infrastrukturën digjitale të të gjitha shërbimeve ka dhënë rezultatin e duhur. Ne sot marrim shërbime në kohën e duhur, me shpejtësinë e duhur dhe me cilësinë e duhur. E thashë, e kam thënë dhe do ta them përsëri, e ngriti edhe zonja në diskutimin e vet, që tashmë që sistemi ka ecur përpara, njerëzit kanë mbetur mbrapa nga pikëpamja e aftësive profesionale për të menaxhuar një sistem të tillë të jashtëzakonshëm, sepse janë të njëjtët njerëz. Unë kam raste që kam ndërruar 3-4 drejtorë për një çështje në një degë të hipotekës dhe sa herë që ndërrohej drejtori, vjen pranë këtij drejtori, kur unë sqaroj hallin, i njëjti person që ka 20 vjet atje dhe thotë se kjo gjë nuk bëhet.

Domethënë, kërkesa jonë është që gjithë këtë punë fantastike, të mrekullueshme që është bërë për përmirësimin e digjitalizimit të shërbimeve, të shpejtësisë, duhet t’i përgjigjet një ekip më profesional. Kam aplikuar jo vetëm unë, por për të njëjtën pronë kanë aplikuar 10 pronarë të njëjtë dhe për të njëjtën çështje kanë marrë 10 përgjigje të ndryshme, pra ai i Kukësit thoshte “I mungon kjo”, ai i Tepelenës thoshte “I mungon kjo gjëja tjetër”.

Nuk dua ta zgjas, por ne duhet t’i mësojmë fort, e tha edhe zonja në diskutimin e vet, integritetit të punonjësve dhe profesionalizmit të tyre.

E dyta, dhe do ta mbyll, ne duhet të rrisim fuqinë administrative të shtetit, sepse shteti nuk është gjykatë, nuk është prokurori, nuk është hetuesi, shteti është administratë. Ne duhet t’i japim shtetit fuqi administrative, që njerëzit të marrin zgjidhje administrative të shteti, të zyra e shtetit jo të thonë “Ti ke të drejtë, por duhet të shkosh në gjykatë, zotëri”, por ne gjykatat i dimë, kemi 20 vjet dhe nuk kemi zgjidhur asgjë, por sigurisht fuqia administrative rritet dhe fuqizohet, duke përmirësuar aktet nënligjore që t’u japin fuqi njerëzve që funksionojnë në shtet. Nga ky këndvështrim do të thosha se ka ardhur koha t’i japim më shumë siguri, më shumë liri dhe më shumë fuqi administratës. Ne duam t’i zgjidhim hallet në administratë jo në gjykatë, gjykata mbaron një çështje, vjen prapë dikush, kap një prokuror, sekuestron dosjen, bllokon pronën dhe kjo histori është shumë e lodhshme në Shqipëri.

Ndaj, ju falënderoj për këtë takim dhe për vlerësimin që u kenë dhënë shoqatave të biznesit! Falënderoj zotin Xhafaj që e ka bërë në mënyrë shembullore këtë gjë!

Faleminderit!

Nadia Rusi – Faleminderit, zoti Bregasi, që ndatë me ne këndvështrimin që shoqata e biznesit ka në kontekstin e rëndësisë që ka menaxhimi i mirë i çështjeve të pronësisë qoftë në kuadër të masave në lidhje me integritetin, qoftë sa i përket forcimit të administratës që e menaxhon këtë proces!

Lorena Goxhobelli – Unë do ta shoh në një prizëm pak më të gjerë.

Faleminderit për prezantimin!

I vlerësojmë analizën dhe gjetjet tuaja, të cilat pasqyrojnë një pjesë të rëndësishme të sfidave aktuale që ka Agjencia Shtetërore e Kadastrës, siç ndajmë absolutisht bindjen që korrupsioni është një pengesë kryesore për zhvillimin dhe besueshmërinë e institucioneve tona.

Kjo nuk është një përpjekje e lehtë dhe kërkon angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithëve, ndaj vlerësojmë ekspertizën, diskutimet dhe rolin udhëzues të këtij komisioni. Nga ana tjetër, është po aq e rëndësishme të njihet fakti se përgjatë viteve të fundit, gjë që doli edhe nga prezantimi juaj, janë hedhur disa hapa shumë të rëndësishëm për të ndërtuar ngrehinën e një institucioni efikas, transparent, të përgjegjshëm në shërbim të qytetarit dhe të mbrojtur nga korrupsioni. Këto përpjekje përfshijnë përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor, nisjen dhe vazhdimin e projektit madhor të digjitalizimit të të dhënave kadastrale dhe ofrimin *online* të shërbimeve.

Ndërkohë ndodh shpesh, dhe doja t'i ktheja përgjigje zotërisë, që pengesat në ofrimin e shërbimit kadastral janë rrjedhojë e një kalvari të gjatë problematikash të trashëguara me pronën dhe shpeshherë perceptohen gabimisht sikur lidhen, në rastin më të mirë, me një paaftësi të punonjësve të ASHK-së dhe, në rastin më të keq, si një tentativë për përfitime të paligjshme. Në fakt, problematikat që kemi trashëguar në kohë janë të shumta, ndoshta shumë nuk e dinë që aktet e marrjes së tokës bujqësore në pronësi janë të pashoqëruara me harta, komisionet e ndarjes së tokës në kohë bënin ndarjen e pronave në zyra pa shkuar dhe pa bërë ndarjen në terren, por edhe kur bënin ndarjen në terren të tyre, e bënin me mjete primitive dhe të gjitha këto kanë bërë që sot të kemi akte të marrjes së tokës në pronësi, të cilat në pjesën dërrmuese të tyre sipërfaqet i kanë jo në përputhje me atë që është faktikisht në terren. Këto nuk janë problematikat e vetme, sepse ne kemi problematika me hartat e krijuara pas regjistrimit fillestar, një mori titujsh të mbivendosur, të prodhuara nga gjykatat apo nga ish-Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe çështjet e mbivendosjeve nuk janë çështje që trajtohen nga ASHK-ja, por janë çështje që i përkasin

gjykatës, madje do të ishte keq për të gjithë nëse ASHK-ja do të bëhej gjykatëse dhe do të vendoste mbi pronësinë e njëres palë apo tjetres.

Rritja e transparencës dhe integritetit bashkë me përmirësimin e shërbimit kadastral janë ndër prioritetet kyçe që synojnë jo vetëm të përmirësojnë performancën institucionale të ASHK-së, por edhe të forcojnë besimin e qytetarëve në sistemin kadastral. Për të përmbushur këtë vizion ASHK-ja po zbaton një sërë iniciativash, të cilat do të doja t'i përmendja: procesi i hartimit të planit të integritetit brenda vitit 2025 në bashkëpunim të ngushtë me ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, i cili do të përfshijë një vlerësim të thelluar të dobësive kryesore të sistemit dhe një plan efikas masash për adresimin e tyre. Plani do të hartohet në një proces gjithëpërfshirës ku do të përfshijmë edhe grupet e interesit, të cilët e shohin ASHK-në edhe si marrës shërbimi edhe si partner në punën e tyre, siç janë: avokatët, noterët, bankat, shoqëritë civile.

Automatizimi i disa prej shërbimeve kadastrale që sot kryhen manualisht, duke eliminuar *imput*-in njerëzor. Që prej janarit 2024 është implementuar teknologjia *block chain* në sistemin multifunksional kadastral, një teknologji inovative, e cila përdoret nga shumë biznese në botë dhe që e bën të mundur ruajtjen e informacionit nëpërmjet blloqeve zinxhir. Një teknologji e tillë e bën të pamundur modifikimin e informacionit në mënyrë të paautorizuar, duke siguruar kështu integritetin e të dhënave. Për ta sqaruar pak më thjesht: një qytetar, një biznes, i cili merr shërbimin pas aplikimit të *block chain*, që është janar 2024, mund të kërkojë rifreskim të dokumentacionit dhe i del në mënyrë automatike pa pasur nevojën e *imput*-it njerëzor. Ne po përpiqemi dhe po shikojmë mundësitë që të shtojmë shërbimet në *block chain* dhe po vlerësojmë për të shtuar marrjen e kopjeve të vërtetuara dhe dokumentacionit tekniko-ligjor. Nga ana tjetër, në sistemin multifunksional, jemi duke zbatuar modulën e përlllogaritjes së tatimit të vlerës për tjetërsimin e pasurisë, që aktualisht e bëjmë me punonjësit tanë. Jemi në fazën që po e testojmë dhe po bëjmë popullimin e këtij moduli dhe mendojmë se shumë shpejt pjesa më e madhe, sepse në këtë rast nuk e eliminojmë dot tërësisht *imput*-in njerëzor, do të bëhet në mënyrë automatike, çka do të japë një shërbim më të shpejtë për të gjithë qytetarët dhe bizneset.

Duke njohur rëndësinë e një regjistri të plotë dhe të besueshëm të pronës si dhe ndikimin që ai ka në rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, ASHK-ja e ka po ashtu pjesë të prioritetëve përshpejtimin dhe përfundimin e regjistrimit fillestar, e cila u përmend edhe nga ju, përmirësimin e të dhënave ekzistuese dhe digjitalizimin e të dhënave kadastrale. Digjitalizimi përfaqëson një

nga shtyllat më të rëndësishme për përmirësimin e shërbimit kadastral. Deri tani ASHK-ja ka arritur të digjitalizojë 40% të kartelave të pasurisë, 60% të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe 10% të hartave. Ne synojmë që brenda 2025-s të arrijmë të digjitalizojmë të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, deri në qershor të vitit 2026 të gjithë digjitalizimin e kartelave dhe brenda vitit 2028 synojmë të përfundojmë digjitalizimin e hartave. Për këtë kemi kërkuar asistencë teknike dhe financiare nga Bashkimi Europian, që shpresojmë të finalizohet në muajt e ardhshëm. Përparimi në këtë drejtim jo vetëm që rrit efikasitetin e ASHK-së, por edhe zvogëlon mundësinë për keqinformim dhe për abuzim.

Siç u paraqit në prezantimin tuaj rreth 80%, dhe ky është fakt, i të dhënave kadastrale vlerësohet se ka nevojë për përmirësim. Ky problem e ka zanafillën që në vitet '90, kur nisi procesi i zbatimit të një sërë procesesh që lidhen me pronën, përfshi regjistrimin fillestar. Kjo situatë ka sjellë jo rrallë herë konflikte, vonesa në dhënien e shërbimit kadastral, moszbatimin e vendimeve gjyqësore duke ndikuar negativisht në efikasitetin dhe besueshmërinë e sistemit kadastral. Pavarësisht burimeve të kufizuara dhe sfidave komplekse që ka ASHK-ja, si një institucion me një mandat shumë të gjerë, ne jemi të angazhuar intensivisht edhe në procesin e përmirësimit të të dhënave kadastrale.

Për të përshpejtuar këtë proces ASHK-ja po shqyrton një sërë masash konkrete, duke përfshirë sigurimin e mbështetjes teknike dhe financiare nga Bashkimi Europian për të përmbyllur procesin e përmirësimit në 20% të zonave kadastrale, me fokus në zonat prioritare që janë zonat suburbane rreth kryeqytetit, qytetet dhe fshatrat me zhvillim të lartë urban dhe turistik.

E di që e kalova kohën, por më duhet t'i marr të gjitha...

Bashkëpunimin me shoqatën e gjeodetëve për të shfrytëzuar ekspertizën teknike që ata ofrojnë dhe për të optimizuar burimet ekzistuese. Jemi duke hulumtuar me ta mundësinë që t'i përfshijmë në këtë proces. Duke qenë se burimet tona financiare dhe teknike janë të kufizuara, bashkëpunimi me ta do të na jepte mundësinë që të arrinim të bënim përmirësim të zonave njëkohësisht në disa teritore. Patjetër që ASHK-ja do të jetë mbikëqyrësi kryesor dhe do të legjitimojë produktin e prodhuar nga këta gjeodetë. Bashkëpunimin me ASIG-un, i cili ka të gjitha teknologjitë më inovative për fotografimin ajror duke përdorur dronë profesionale posaçërisht për të mbështetur punime të tilla kadastrale.

Siç u përmend edhe më parë në prezantim, regjistrimi fillestar është një tjetër proces shumë kyç për krijimin e një sistemi të saktë dhe të plotë kadastral. Kemi përfunduar 2779 zona, të cilat

përbëjnë 90% të zonave kadastrale, megjithatë procesi është ende duke u përmbyllur për 279 zona të mbetura kadastrale. Planifikimi është që brenda qershorit të vitit 2026 të arrijmë të përmbyllem 126 zona kadastrale, duke përmbyllur kështu një angazhim të marrë nga shteti shqiptar në kuadër të agjendës së reformave në Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor për realizimin deri në 95% të zonave kadastrale të përmbyllur me regjistrim fillestar. Pjesën e mbetur të zonave kadastrale do ta përfundojmë brenda afatit ligjor që është vendosur me ligjin nr. 20/2020, që është viti 2028.

Objektivat e përmendur qoftë regjistrimi fillestar, qoftë digjitalizimi i të dhënave, përmirësimi i të dhënave kadastrale nuk janë thjesht objektivat teknikë të ASHK-së, por janë gur themeli për krijimin e një sistemi të plotë, të qëndrueshëm, të besueshëm të pronës që garanton të drejtat e pronës, redukton abuzimet, promovon transparencën dhe fuqizon ekonomikisht dhe nga pikëpamja sociale vendin.

Për realizimin e këtyre objektivave, të cilat kërkojnë burime financiare dhe ekspertizë teknike, jemi të pritje të mbështetjes së qeverisë dhe të Bashkimit Europian, dhe shpresojmë që në muajt e ardhshëm, shumë shpejt, do të arrijmë ta konkludojmë.

Në lidhje me proceset kalimtare ju përmendët shifrën 2,9%, unë mendoj se kjo shifër nuk jep një pasqyrë të saktë të procesit ndër vite. Në realitet të dhënat tregojnë se procesi ka pasur dinamika të ndryshme në periudha të caktuara: një mungesë totale e legalizimeve nga viti 2006 deri në vitin 2009, me një rritje të ulët nga viti 2009 deri në vitin 2013 dhe me një rritje të dukshme nga viti 2013 deri në vitin 2024. Në total 62,5% e aplikimeve janë trajtuar, nga të cilat 92% i përkasin periudhës 2013-2024, duke dëshmuar një intensifikim të procesit në këtë periudhë. Megjithatë, ne kemi ende një masë të dosjeve që mbeten për t'u shqyrtuar dhe duke qenë se kemi një afat ligjor që është viti 2028, aktualisht kemi futur në këtë proces edhe bashkitë, jemi ende me ta në finalizimin e marrëveshjeve, në detajimet logjistike dhe teknike, dhe mendojmë se do t'i japë një hov të ri për të përmbyllur procesin brenda vitit 2028.

Nadia Rusi – Faleminderit zonja Goxhobelli për të gjitha masat dhe hapat që janë marrë në kontekstin dhe në përgjigje të gjetjeve të analizës!

Unë ju falënderoj për të gjithë mbështetjen që na ka dhënë sekretariati teknik pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në kontekstin e dokumentit analitik. Mbase një pjesë e çështjeve mund të dalin në vazhdim të diskutimit.

Faleminderit!

Fjala për zotin Kryeministër.

Edi Rama – Shumë faleminderit!

Unë, për hir të së vërtetës dëshiroja të merrja pjesë një nga tryezat dhe duke qenë se kishin mbetur tri tryeza dhe kjo, mos gabohem, është tryeza e nëntë, midis tri temave të mbetura për këtë lloj diskutimi në këtë fazë të procesit m'u duk e udhës të zgjidhja tryezën tuaj për shkak të ndjeshmërisë së lartë që ka për publikun, për qeverinë, por edhe për BE-në tema e pronës. Nuk jam këtu për të dhënë mend, sepse qëllimi kryesor i këtij komisioni të posaçëm dhe i gjithë këtij grupi të madh ekspertësh të pavarur, që janë angazhuar në funksion të kësaj pune të jashtëzakonshme për nga volumi, por e çmoj si të jashtëzakonshëm edhe për nga prurja e opinioneve dhe e këndvështrimeve, si rezultat i gjithë këtij grupi ekspertësh, është që Parlamenti të bëhet epiqendra e një ndërveprimi intensiv që fillon me këtë fazë të këtij procesi, që në këndvështrimin tim duhet të vijojë deri në momentin që Shqipëria do të anëtarësohet në Bashkimin European. Mënyra se si komisioni i posaçëm do të transformohet në një mekanizëm permanent brenda Parlamentit dhe në një pikë referimi për të gjitha institucionet e këtij shteti, do të përcaktohet, shpresoj, nga vetë ky proces, ku do të dalin konkluzionet dhe detyrat për të gjitha institucionet dhe për të tria pushtetet, për pushtetin legjislativ, pushtetin ekzekutiv dhe për pushtetin gjyqësor.

Do të më pranoni shprehjen e mirënjohjes për të gjithë ju dhe për të gjithë ekspertët dhe njëkohësisht edhe një shprehje solidariteti për ata ndër ju, që jeni pjesëmarrës në këtë proces, që në këndvështrimin tim është një proces patriotik, sepse ka një domosdoshmëri për të krijuar një front të madh mbështetës për Shqipërinë që negocion anëtarësimin e vet në Bashkimin European. Pastaj është edhe një proces thellësisht teknik, ku është e pashmangshme, por njëkohësisht dhe e paarsyeshme të imagjinohet që ky proces thellësisht teknik mund të përballohet me burime të brendshme që ka qeveria apo dhe institucionet e tjera, që negociojnë anëtarësimin sipas sektorëve të tyre, pikërisht se ekspertët u angazhuan, u bënë edhe target i gjithfarëlloj akuzave, i gjithfarëlloj insinuatave, i gjithfarëlloj goditjeve në kanale televizive dhe rrjete të ndryshme të thashethemnajës së madhe publike, që në këndvështrimin tim, gabimisht quhet e gjitha “liri e fjalës”.

Thënë gjitha këto, dua të nënvizoj tri gjëra. E para, lidhur me këtë proces dhe me këtë komision. Në këndvështrimin tim ky komision është sot, në kushtet që po flasim, një instrument i pazëvendësueshëm dhe i patjetërsueshëm për suksesin tonë në procesin e anëtarësimit dhe për suksesin tonë në negociatë, sepse në Bashkimin European ne nuk shkojmë si qeveria e Shqipërisë që i përfaqëson të gjithë, por shkojmë si një front institucionesh që përfaqësojnë tri pushtetet, të

cilat në marrëdhënie me njëri-tjetër kanë hapësira komunikimi dhe ndërveprimi, por kanë edhe kufij, sepse janë të pavarur nga njëri-tjetri. Kjo do të thotë që koordinimi i gjithë këtij fronti dhe ecja në mënyrë uniforme për sa i përket performancës, në raport me negociatat e të gjitha institucioneve, mund të garantohet vetëm nëse Kuvendi bëhet një udhëkryq, ku të gjitha forcat që veprojnë e ndërveprojnë në emër të shtetit të Republikës së Shqipërisë pikëtakohen dhe nga ana tjetër të gjitha këto forca mund të japin llogari, sepse mund t'u kërkohet llogari. Ky është thelbi i procesit. Nëse në ecurinë e negociatave përparon qeveria dhe nuk përparon një "x" institucion, një "x" agjenci, një "x" strukturë, që nuk është nën urdhrat e qeverisë dhe që qeveria nuk mund t'i kërkojë llogari, atëherë, cili është autoriteti dhe cili është instrumenti që ky institucion të vendoset para përgjegjësisë publike dhe përpara përgjegjësisë patriotike për të dhënë llogari? Askush dhe askund tjetër përveçse në Kuvendin e Shqipërisë mund të kërkohet një forcë e tillë.

Përfshirja e një mase kaq domethënëse të shoqërisë, përmes botës akademike, përmes rrjeteve të ndryshme të shoqërisë civile, përmes medieve dhe përmes shumë të tjerëve, është një garanci shumë e madhe për të synuar dhe për të nxjerrë maksimumin e mendimit intelektual dhe të cilësisë në qasjen tonë ndaj problematikave të ndryshme që shfaqen.

E dyta, që dua të theksoj, është se shumëkush dhe gjithmonë, në fakt, sa herë që ka një iniciativë të re, sa herë që ka një përpjekje të re, sa herë që ka një synim të shprehur për një hap të ri, ngrihet dhe thotë: "tani u kujtuat ju". Në fakt, unë besoj se nuk jemi kujtuar tani, por jemi kujtuar që ditën e parë që kemi ardhur në këtë detyrë, por ama në çdo hap të rrugës ka sfida të reja dhe nga ana tjetër, çdo hap kërkon kohën e vet dhe forcën e vet.

Duke folur për pronën, është e qartë, nëse e kthejmë kokën mbrapa, (drejtoresha e Kadastrës dhe një informacion në lidhje me volumin e legalizimeve të kryera, që nga krijimi i institucionit të legalizimeve, pas daljes së ligjit mbi legalizimet), atëherë kuptojmë dy gjëra, që ajo që është bërë është shumë voluminoze dhe përmirësimi është shumë i ndjeshëm në raport me pikënisjen, por i pamjaftueshëm në raport me pikëmbërritjen. Tani, pikëmbërritja jonë është ulja në tryezën e Bashkimit Europian.

Përgëzime për vendosjen e kohës, por unë po abuzoj, se është i vetmi vend në Republikën e Shqipërisë ku unë kam dëgjuar nga presidiumi të vendoset një afat 3 minuta, sepse i njëjti afat vendoset në mbledhjet e NATO-s dhe të BE-së. E vetmja mangësi që duhet ta rregulloni është që të vendosni edhe një kronometër, që vendoset përpara gjithë folësve dhe kur mbaron minutazhi mbyllet mikrofoni. Për sa kohë ju e keni këtë mangësi, unë po e shfrytëzoj këtë boshllëk.

Pra, është themelore të kuptohet që për sa kohë pikëmbërritja jonë është Bashkimi European, atëherë volumi i punës për t'u bërë është jo vetëm shumë më i madh sesa volumi i punës së bërë, por është edhe i panegociueshëm. Ata thonë që janë negociata, por, në fakt, nuk janë negociata, por janë detyra shtëpie që duhet t'i bëjmë, sepse jemi ne që duam të hyjmë në shtëpinë e tyre dhe nuk janë ata që duan të hyjnë në shtëpinë tonë. Pra, këto janë rregullat dhe ne duhet t'u nënshtrohemi për një arsye shumë të thjeshtë, sepse, nëse ne i zbatojmë si duhet këto detyra, ky shtet do të jetë përfundimisht një shtet me standardet e një vendi anëtar të Bashkimit European.

E mira e këtij procesi nuk është se ne do të marrim Shqipërinë dhe do ta çojmë në Bruksel, por ne do të fusim Europën në Shqipëri, në gjithë gjymtyrët e shtetit dhe të shoqërisë, duke garantuar lirinë individuale në mënyrë të plotë, në të gjitha aspektet, duke garantuar sundimin e ligjit, në të gjitha aspektet dhe duke garantuar procesin demokratik, në të gjitha aspektet. Këto janë tri gjëra që askush nuk i bën për ty dhe askund tjetër përveçse në këtë proces nuk mund të bëhen në kohë. Nëse shumë vende në zhvillim kanë pasur ambicien të demokratizohen dhe të arrijnë standarde që i garantojnë këto tri gjëra, ka një arsye pse.

Po marr dy shembuj, në Afganistan nuk funksionon, në Irak nuk funksionon, ndërsa në Ballkan funksionon. Për mua arsyeja është vetëm një, ne kemi mundësinë që të marrim dijen e Bashkimit European, kemi mundësinë që nga ndërveprimi me Bashkimin European të hedhim këto hapa dhe kemi bekimin që jemi në mes të Europës, ku kemi Bashkimin European. Nëse nuk do të kishim procesin e integritetit dhe nëse nuk do të kishim Bashkimin European një aleat strategjik, por edhe një mundësi që vjen nga të qenit në mes të Europës, ne do të duhet ta harronim, siç e harruan afganët, siç e kanë harruar edhe vende të tjera, që mund të vinte një ditë që të bëheshim një vend me këto standarde.

Në mbyllje dua të theksoj se sot është plotësisht e mundur që të realizojmë ambicien për t'u anëtarësuar në Bashkimin European, edhe duke plotësuar të gjitha kriteret që lidhen me pronën, sepse sot kemi me vete bekimin e kohës falë teknologjisë. Nëse nuk do ta kishim këtë bekim, të gjitha këto procese do të merrnin shumë më tepër kohë.

Para se të vija këtu pashë një produkt të fundit të inteligjencës artificiale, për sa i përket transferimit të ligjeve të Bashkimit European në Shqipëri. Është e jashtëzakonshme po të mendosh se Kroacia, që hyri para nesh në Bashkimin European, për të bërë procesin vetëm të kalimit të legjislacionit nga pikëpamja mekanike mori 7 vjet dhe për të bërë këtë ka angazhuar një numër të jashtëzakonshëm përkthyesish, redaktorësh, korrektorësh e të tjerë. Ndërkohë, nga produkti që

kemi nxjerrë përmes inovacionit, ne kemi transferimin e ligjeve nga anglishtja në shqip me një shpejtësi të jashtëzakonshme dhe me një kualitet të jashtëzakonshëm. Jo vetëm kaq, por modeli i inteligjencës artificiale do të na japë mundësi jo vetëm t'i transferojmë ligjet, por të kemi edhe të dhëna krahasimore, të kemi të dhëna mbi impaktin e ligjeve, sepse çdo ligj mbrapa ka fatura, ka konsekuenca dhe një sërë gjërash të tjera. Ky është vetëm një shembull që vlen edhe për Kadastrën, sepse duke pasur teknologjinë ne mund të bëjmë hapin e fundit për të përmbyllur një proces që ka marrë shumë kohë, por mund të merrte edhe më shumë kohë. Kjo nuk është një barsolëtë, por është një shembull real nga proceset gjyqësore në Shqipëri. Meqë zonja, e cila e hapi këtë tryezë solli një shembull, edhe unë po e mbyll me këtë shembull, me rastin e një konflikti prone që shkon në gjykatë dhe gjykata disponon hartën, por harta, nga palosja dhe shpalosja kushedi se sa herë e gjithë atij territori, në cepat e palosura kishte vrima. Në vendimin e gjykatës shkruhet shprehimisht: “Konflikti nuk zgjidhet dot se prona është në vrimë”. Kështu që ky ka qenë procesi, kjo ka qenë sfida dhe tani të gjitha llojet e vrimave, që përndryshe do të ishte dashur një kohë shumë e gjatë për t'i mbyllur, mund të mbyllen falë teknologjisë, falë *block chain*-it të inteligjencës artificiale e të tjera.

Në këtë aspekt unë jam shumë optimist, sepse kemi shumë progres në të gjitha strukturat e qeverisjes dhe shpresoj që edhe pushtetet e tjera, legjislativi apo sistemi i drejtësisë, të bëjnë shumë më tepër në këtë aspekt, sepse nëse nuk e bëjmë të gjithë këtë gjë, atëherë përsëri mbetemi si një territor, ku sistemi nuk e ka mundësinë të ofrojë të gjithë atë që mund të ofrojë për shkak se nuk është gjithë shteti i kyçur në sistem. Kjo vlen për pronat, kjo vlen për të gjitha.

Asistenca teknike e BE-së është shumë e favorshme, ndërkohë që kemi edhe procese pozitive edhe me vende të veçanta. Sjell këtu rastin e Greqisë, duke qenë se edhe Greqia tani po e bën digjitalizimin e Kadastrës, duke qenë se edhe Greqia ka pasur probleme shumë të ngjashme, edhe pse shumë të ndryshme nga tonat në raport me pronat, duke qenë se edhe Greqia ka një rekord të qenësishëm si vend mesdhetar ndërtimesh pa leje, në këtë aspekt fakti që Greqia është më përpara dhe, njëkohësisht ka një ekspertizë, por është edhe në Bashkimin European, duke pasur edhe një përkujdesje të posaçme lidhur me trajtimin e minoritetit nga ana jonë, duke qenë Greqia një vend që kërkon vazhdimisht që vëmendja ndaj minoritetit të jetë e pandërprerë, ajo çka ka prodhuar edhe ngërçe në të kaluarën, për arsye që unë nuk i hyj këtu sot, është, në fakt, një mundësi, një platformë pozitive bashkëpunimi dhe bashkërendimi.

Ju falënderoj shumë edhe një herë për të gjithë kontributet! Luani e tha, që në fillim u ngatërruam shumë, se na u tha që ky komision u ngrit për të bërë një pabesi të madhe në kurriz të drejtësisë, nuk e tha me këto fjalë se ai ka më shumë eksperiencë se unë në këto tryeza, në këtë godinë, por fakti është se në fund fare të gjithë pa përjashtim, ata që duan të kuptojnë, do të shohin se ky komision dhe çfarë do të dalë nga ky komision, do të jenë një kontribut i pazëvendësueshëm në anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe kjo e bën kontributin e të gjithë ekspertëve një kontribut historik. Fjala historik në Shqipëri përdoret shumë shpesh për arsye që nuk kanë të bëjnë fare me historinë. Në këtë rast ky është një kontribut historik, sepse ky është një proces historik.

Edhe një herë tjetër ju falënderoj dhe të gjithë ata që u lënduan nga goditjet në fillimet e procesit duhet të jenë shumë krenarë për këtë kontribut dhe, njëkohësisht, nga eksperiencia ime si njeri i sprovuar në ngarkesat e baltës mund t'ju them që çfarë nuk të vret, vetëm të forcon. Kështu që mos kini asnjë merak që balta në këtë rast e zëvendëson plotësisht hudhrën dhe nuk ju merr dot njeri mësysh.

Nadia Rusi – Faleminderit, zoti Kryeministër, për kohën që i kushtuat kësaj tryeze!

Faleminderit për këshillën!

Prandaj, edhe ne ndonjëherë e themi që kanë shumë rëndësi rregullat në proces, por është e rëndësishme edhe të dish ta menaxhosh mirë procesin. Unë këtë po e marr si një autokritikë për veten në kontekstin e kohës, por do ta rregullojmë me të gjithë folësit e tjerë kronometrin. Pra, qëndron i njëjti rregull, tri minuta për të gjithë pjesëmarrësit në vazhdim të diskutimit.

Faleminderit!

Elona Saliaj – Përshëndetje!

Jam Elona Saliaj, jam notere, njëkohësisht jam drejtuese e Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve.

Procesin e pronës, e sidomos të sistemit të regjistrimit, thjesht sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe aktualisht ASHK-në e njoh shumë mirë, edhe për shkak të një studimi pasuniversitar që kam bërë për rreth 5 vjet, duke e krahasuar sistemin e regjistrimit shqiptar me të gjitha vendet e Europës Juglindore dhe me vendet europiane. Unë kam evidentuar se ai që na ne na penalizon sot është fakti historik. Pavarësisht se duam apo jo, përpara viteve '90 kemi qenë i vetmi vend në Europën Juglindore që mbi 90% e sipërfaqes së pasurisë së paluajtshme ka qenë në

pronësi shtet, ndryshe nga gjithë vendet e tjera të Europës Juglindore, të cilat e njohën pronësinë private.

Së dyti, problematika tjetër ishte që pas vitit '90 u dyndëm për të hartuar legjislacione pa fund, sepse e dëgjova fjalën juaj që thate se do të duhet të ndryshojmë legjislacionin. Për statistikë po ua jap që nga viti '90 e në vijim është ndryshuar ligji për pronat dhe për pasuritë e paluajtshme mbi 130 herë.

E parë në aspektin makro, domethënë nga dikush nga lart, duket sikur ka zhvillim, në fakt, sepse ndryshimi, reforma gjithmonë krijon zhvillim.

Ne që punojmë dhe që i dimë çdo ditë problematikën, në fakt shikojmë që ndryshimet e evidentuara nuk kanë sjellë ndryshime edhe në realizimin e përfitimit të pronësisë, sepse, ashtu sikurse u përmendën, ka raste të mbivendosjes së pronësisë, ka raste të fitimit të pronësisë, të shitjes dy herë që nuk është përmendur, por do të doja që të vendosej patjetër, meqenëse prezent kemi edhe biznesin, sepse që nga viti 2012 ka pasur një VKM që i detyronte të gjitha shoqëritë për të regjistruar pasuritë në regjistrin e Kadastrës dhe nuk i regjistronin. Në 2016-ën ka pasur një udhëzim të hollësishëm që i detyronte t'i regjistronin dhe ndërkohë noterët të mos lejoreshin për t'i tjetërsuar dhe në 2018-ën me ligjin për kadastrën është vendosur që patjetër duhet të regjistrohen. Në fakt, bizneset nuk i regjistrojnë, fatkeqësisht, mund të ketë dhe kolegë që i kalojnë. Kështu që filtri i kontrollit kam përshtypjen se është shumë i rëndësishëm në gjithë këta sektorë.

Gjithashtu, do të doja të veçoja pak edhe faktin për ndryshimet, dhe jo më kot e thashë që jam drejtuese e Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, sepse nga viti 2021, kur u themelua kjo qendër, janë bërë mbi 40 trajnime në vit për noterët për tematika të ndryshme. Në secilin trajnim, ku kam qenë prezent, kam evidentuar që shumë nga gjërat, të cilat janë të shkruara, janë ligje, janë të hartuara, e të gjitha me radhë, nuk kishin arritur të perceptoheshin nga kolegët e mi dhe trajnimi ishte shumë i rëndësishëm.

Kështu që unë do ta inkurajoja dhe drejtuesen e qendrës së Kadastrës, e cila, në dijeninë time, ka ndërmarrë një iniciativë për të hapur dhe për të bërë trajnime për specialistët e saj dhe për të vijuar me ato lloj trajnimesh, që të mos ketë juristë të ndryshëm që të japin përgjigje të ndryshme, por të ketë unifikime mbi bazën e tyre. Meqenëse i njoh shumë mirë dhe nga ana praktike rastet e pronësisë, klientët kur vijnë më thonë: a jam 100% i sigurt tashmë me këtë pronë? Përgjigjja ime e sinqertë është: 100% i sigurt je për pasigurinë juridike, ndaj hajde të flasim nëse je 98, 97 apo 96.

E them këtë krahasuar dhe me vendet e tjera europiane, sepse ne marrim origjinën e fundit të pronësisë dhe atë çka unë shikoj që është e regjistruar, por unë nuk di gjithë historikun e saj, që mund të jetë regjistruar me një AMTP të falsifikuar, mund të ketë një mbivendosje, e cila nuk më pasqyrohet në regjistrin kadastral dhe të gjitha këto lloj problematikash nuk i marr dot përsipër. Do të ishte shumë mirë dhe e paarrtshme ndoshta sikurse e ka Anglia, për shembull, që kur ti blen një pronë, të jep bashkë me të dhe një USB dhe të thotë: ke të gjithë ndryshimet që janë bërë mbi këtë pronë nga viti 1912 e në vijim.

Ne nuk mund të pretendojmë kaq shumë, por ajo çfarë do të duhet të pretendojmë është një lloj historiku i asaj prone dhe problematikat, që blerësit, qoftë ky edhe i huaj, sepse ne kemi shumë blerës të huaj që po na paraqiten, do të duhet t'ia japim të plotë panoramën.

Ndryshimet, në fakt, nuk do t'i kërkoja shumë ligjore, se ne kemi një tendencë për të ndryshuar vazhdimisht ligjin. Ligjet janë shumë të mira, Kodi është shumë i mirë. Ato që na kanë penguar gjatë gjithë kohës janë aktet nënligjore dhe vënia në zbatim e tyre, por edhe kontrolli dhe trajnimet e vazhdueshme, sepse nuk ka kohë asnjë specialist që të ulet dhe të lexojë veçmas. Duke bërë trajnime, duke dëgjuar dhe duke marrë një lloj unifikimi në lidhje me praktika të ndryshme, do t'i ndihmojë së tepërmi.

Sa i përket pjesës së korrupsionit, mendoj se janë njerëzit të edukuar të tillë dhe kam përshtypjen se nuk është sistemi. Në zyrën time nuk guxon njëri të më thotë: a mund të të jap diçka që ta bëj më shpejt, sepse direkt do të shkoj në denoncim dhe nuk guxon asnjë specialist, deri më sot i ASHK-së që të më kërkojë apo të më zvarrisë procesin, sepse ASHK-ja mund ta ketë shumë të njohur emrin tim, që unë me shkresa i kam zgjidhur të gjitha problematikat, qoftë edhe më të vështira, vetëm nga ankesat që kam adresuar. Prandaj, pak problemin do të duhet ta shikojmë edhe te vetja dhe jo të na zgjidhen gjërat sikurse me magji.

Faleminderit!

Nadia Rusi – Faleminderit, zonja Saliaj!

Për sa u përket çështjeve që ju ngritët në kontekstin e kësaj tryeze, në fakt, është e vërtetë, është një nga sektorët dhe një nga çështjet ku kemi pasur ndryshimet më të shpeshta të kuadrit ligjor, prandaj edhe unë jo më kot e përmenda që duket sikur ramë në qetësi nga 2017-ta dhe në vazhdim me miratimin e kuadrit në fuqi, gjithashtu edhe për rëndësinë që ka trajnimi i punonjësve, miratimi dhe garantimi i zbatueshmërisë së të gjitha akteve me karakter nënligjor.

Reinaldo Phipria – Përsëritje!

Jam Reinaldo Pipiria nga NAREA, Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë.

Faktikisht është hera e dytë që marrim pjesë në komision dhe është vërtet kënaqësi, ndaj faleminderit, zoti kryetar, zoti Xhafaj, që na keni bërë pjesë!

Vërtet në dy tavolina, ku kemi qenë pjesë, kemi vënë re se bëhet një analizë e spektrit ligjor, bëhet një analizë e praktikave që kanë lidhje me administratën, por nuk bëhet një analizë edhe e praktikave dhe e kuadrit ligjor, i cili lidhet me sektorin e biznesit.

Normalisht në jetën ekonomike, politike dhe sociale të një vendi ka një trinom: ligjvënësi, ekzekutivi, si dhe sektori i biznesit, që në një pjesë të mirë të kohës nuk janë funksione publike të deleguara, siç janë noterët, por luajnë rolin e gardianëve, të *gatekeeper*-ve, siç janë në rastin konkret ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme. Faktikisht ne i jemi bashkuar të gjithë armatës dhe të gjithë frontit për të ruajtur shëndetshmërinë e sektorit financiar, rishtazi në mars të vitit 2022, por kemi vënë re që ka disa fenomene, të cilat janë duke e cenuar si biznes, por edhe në luajtjen e funksionit, pse është i rregulluar ky si sektor biznesi, ashtu siç duhet të ishte i ngjashëm me Gjermaninë, për shembull. Për shkak të një barre të lartë dhe një standardi shumë të lartë ligjor, është duke u bërë jo atraktiv si funksion, jo i pëlqyeshëm nga qytetarët dhe është duke u devijuar si shërbim dhe si funksion, nga sektori i një profesioni të rregulluar, të rëndësishëm publik, në një treg ku 80% kryhet totalisht në një mënyrë private, ndoshta dhe të pakontrolluar. Është i rëndësishëm për shkak se në të gjitha të dhënat që kemi nga ASHK-ja, 1/3-ta e veprimeve që bën ASHK-ja janë transaksione me pasuri të paluajtshme, pra 37 900. Në të njëjtën kohë, ky sektor ka një kontribut kyç në 1/3-tën ekonomisë. Pra, luan rol si një pol orientues, si në aspektin ekonomik, midis ndërtimit dhe turizmit, ashtu në të njëjtën kohë, luan edhe rolin e *gatekeeper*-it për *money laundering*, por edhe për korrupsionin.

Kështu që është me vend për t'u parë ose të forcohet si funksion, duke bërë ndërhyrjet e nevojshme ligjore, të orientohet. Ndoshta të mos bëhet i detyrueshëm, por të orientohet në njëfarë mënyre, që qytetarët të mësohen që duhet të shkojnë për efekte sigurie në këtë drejtim, ose të gjendet një mundësi për t'u ulur barra ligjore, për shkak se duhet të luajmë rolin në sistem.

Në njëjtën kohë, patjetër që e përkrahim rolin që ka ASHKA-ja, është bërë një punë shumë e mirë, pavarësisht se vërejmë që ka akoma problematika me shpejtësinë e trajtimit të aplikimit të transaksioneve. Një theks patjetër që është pjesa e burimeve njerëzore, por jo domosdoshmërisht duhet të jenë burimet njerëzore zgjidhje të problemit, duhet të jetë avancimi

teknologjik dhe jo vetëm avancimi teknologjik, për t'u mbajtur informacioni brenda mureve të ASHK-së, por krijimi i aksesit ndaj profesioneve të rëndësishme, të rregulluara, siç jemi ne, pra përfaqësuese të interesave ekonomike në transaksione.

Kështu që do të sugjerim, ndoshta nuk duhet të ketë domosdoshmërisht një ndërhyrje ligjore, por duhet të ketë një hapje të databazave për të lexuar të dhëna dhe për të garantuar të drejtën e pronës dhe transaksionit. Ndoshta jo aq perfekte sa Gjermania, por mjaftueshëm mirë sa Mali i Zi, për shembull, që sot i ka databazat të aksesueshme nga profesionistët e rregulluar.

Ndërhyrja e tretë është në lidhje me politikat fiskale. Shpeshherë ne nuk i trajtojmë politikat fiskale dhe rolin që ato kanë në dekurajimin e korrupsionit. Politika fiskale dhe mënyra se si ne merremi me pronat dhe me transaksionet me pronat jo vetëm që nuk e dekurajon korrupsionin, por shpeshherë, gabimisht, mund të krijojë atë atmosferën ku korrupsioni mund të kanalizohet. Pra, inkurajimi pa dashje i informalitetit, krijon një atmosferë që korrupsioni jo të dekurajohet, por të gjejë rrugët e shpëtimit.

Dhe për të tria këto pika, patjetër që ne kemi kapacitetin dhe dëshirën të ulemi për të punuar, për t'i adresuar.

Faleminderit!

Nadia Rusi – Faleminderit! Shumë faleminderit!

Do të mbahen shënime edhe nga ekspertët për sa i përket përmirësimit të dokumentit analitik, të gjitha propozimet dhe gjetjet që ju keni.

Fjala për ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor.

Arbjan Mazniku – Së pari, shumë faleminderit për ftesën dhe mundësinë për të qenë pjesë në këtë diskutim!

Kam përshtypjen se diskutimi, veçanërisht në thellësi të këtyre temave, na jep mundësinë, herë pas here, që përveç nxitimit të përditshëm, gjëra që janë shumë të rëndësishme, si kjo temë, të ndalojmë t'i shohim pak në distancë dhe të vlerësojmë gjëra që mund dhe duhet ndoshta të ndryshojmë në sistem, në makro. Unë do të fokusohem, kam vënë *timer*-in vetë këtu që, do t'i qëndroj kohës, te dy-tri pika që kanë të bëjnë në mënyrë të posaçme me pushtetin vendor.

Së pari, pushteti vendor, bashkitë e vendit disponojnë teorikisht pronë, sipas ligjit nr.139 “Për organizimin e pushtetit vendor”. Për fat të keq, ky është një ushtrim, i cili ndodh në teori, por ndodh shumë herë më pak në praktikë. Pjesa më e madhe e pronave janë të paregjistruara në

emër të bashkive dhe unë besoj se në mënyrë sistematike, nga pikëvështrimi normativ i mënyrës se si regjistrohen pronat, te detyra e tyre për t'i regjistruar pronat, te mbështetja teknike që bashkitë t'i regjistrojnë pronat, kemi nevojë të gjitha palët të bëjmë më shumë për të pasur mundësi që bashkitë si fillim t'i regjistrojnë dhe ta kenë një proces të lehtësuar, pasi fakti që ka prona, që teorikisht janë në pronësi të bashkive, por janë të paregjistruara, ato kthehen jo rrallë herë si ato mëlçitë që u varen ujëve si mekanizëm i mundshëm për opsione korrupsioni, lëvizshmërie për të gjitha palët. Në qoftë se ato regjistrohen, zgjidhim një problem jo të vogël.

Së dyti, është e pastrukturuar siç duhet nga ana normative e drejta e bashkive për të disponuar mbi pronat. Që do të thotë, ne e kemi thënë që bashkitë kanë të drejtën e pronës dhe e gëzojnë këtë të drejtë lirisht, por nga ana tjetër, nga pikëvështrimi administrativo-procedural është po aq kompleks disponimi i një prone bashkiake 500 metra, 100 metra në një fshat të largët, sa është ndoshta edhe një pronë shumë e madhe që duhet për një gjë të rëndësishme. Pra, krijimi potencialisht i normave të posaçme që të facilitojmë mënyrën se si bashkitë disponojnë pronat, mund të çlirojë, gjithashtu, energji të dobishme në ekonomi, por edhe në të gjithë konceptin e menaxhimit të pronës dhe disponimit të pronës që, në fakt, është objektiv fundor. Dhe me këtë do të mbyll pjesën e bashkive.

Ngushtësisht, argumenti i dytë ka të bëjë me një element që ne, gjithashtu, e nënvlerësojmë, për fat të keq, që është prona e përbashkët. Ne kemi qartësi shumë të madhe për ato që janë prona private, çfarë është imja, e kemi të qartë gjithandej, e dimë të gjithë. Gjithashtu, jemi të qartë se çfarë është pronë publike, që është e të gjithëve, rruga, bulevardi, por kur hyjmë në diskutimin e pronave të përbashkëta veçanërisht, dhe kjo është një sipërfaqe shumë e madhe prone...

Pra, çdo pallat ka një sipërfaqe shumë të madhe në bashkëpronësi, e cila, për fat të keq, edhe nga pikëvështrimi i regjistrimit dhe nga pikëvështrimi i të drejtave mbi këtë sipërfaqe prone, por dhe nga impakti që ajo ka në përditshmërinë në jetën e njerëzve, është e pavlerësuar siç duhet.

Ne tashmë jemi duke bërë një ligj të ri për bashkëpronësinë, i cili është në konsultim publik, por përveç thjesht elementit ligjor, ka nevojë për një seri elementesh që kanë të bëjnë me mënyrën si regjistrohen pronat në bashkëpronësi, si disponohet, si ndryshohen, si alternohen, që janë çështje të rëndësishme që ndikojnë në shumë faktorë të ndryshëm, jo thjesht te bashkitë. Dhe besoj që është një temë, e cila meriton pak më shumë diskutim dhe vëmendje.

Faleminderit!

Nadia Rusi – Shumë faleminderit, zoti Ministër, për rëndësinë që ka, në fakt, kjo çështje dhe në kontekstin e iniciativave në kuadër të pushtetit vendor!

Fjala për zonjën Vorpsi.

Arta Vorpsi – Faleminderit, zonja Rusi!

Së pari, faleminderit edhe për ftesën!

Unë jam Arta Vorpsi. Jam pedagoge e së Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë.

Në fakt, u mata për të folur, pasi dëgjoja disa nga kolegët në tryezë, sepse diskutimi m'u duk shumë teknik dhe unë si pedagoge e së Drejtës Kushtetuese nuk jam në gjendje të marr pjesë në këtë diskutim teknik, shumë të detajuar, por do të përpiqem të them, të komentoj diçka lidhur me garantimin e të drejtës së pronës, duke u nisur nga ajo që parashikon Kushtetuta e Shqipërisë.

E drejta e pronës është e garantuar dhe, në fakt, ka një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore me një kuadër tepër të plotë institucional për garantimin e saj. Kështu që, më thënë të drejtën, e kam të vështirë, për shkak edhe të formimit tim pak konservator në pjesën e prodhimit të ligjeve, sidomos kur s'janë të nevojshme, të gjej në këtë fushë të së drejtës nevojën për të shtuar aktet ligjore ose për të shtuar kuadrin ligjor, duke u bashkuar me atë që tha kolegja nga noteria.

Në rolin tim si eksperte e të drejtave të njeriut kam pasur rastin të bëj së fundmi, të përgatis një guidë për të drejtën e pronës, e cila ka në fokus të gjithë vendimmarrjen e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje. Kjo ka qenë në kuadër të një projekti mjaft efikas të Këshillit të Europës “*Horizontal Facility*”, ku Shqipëria është një nga përfituesit me komponentin kryesor, garantimin e të drejtës së pronës. Dhe nëse do ta përmbledhja, edhe për shkak të faktit që kemi shumë pak minuta, problematika e së drejtës së pronës në Shqipëri ka vetëm dy shtylla kryesore: sigurinë juridike dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore. Që do të thotë, të dy këta komponentë janë të lidhur me organet ligjzbatuese jo me kuadrin ligjor, me plotësimin apo ndryshimin e tij, i cili, për fat të keq, më duhet ta them që ka ndryshuar kaq shumë sa që ndonjëherë ne nuk e ndjekim dot, pra cilat janë ndryshimet më të fundit, gjë që më shumë, në mendimin tim si eksperte, krijon amulli sesa qartësi.

Prandaj edhe nga diskutimet që bënë pjesëmarrësit në këtë tryezë, si për garantimin e së drejtës së pronës nga njëra anë, të çështjeve të trashëguara për arsye të ndryshme, pra të ish-pronarëve apo të AMTP -ve e të tjera, ashtu edhe për kategorinë e dytë që lidhet me biznesin, që është po aq e rëndësishme sa e para, na rezulton që, nëse do të kemi thjesht një proces

digjitalizimi të përfunduar, të gjitha hallet tona mbarojnë dhe e drejta e pronës është e garantuar.

Nëse do të kishim organe ligjzbatuese pak më fleksibël, më të zhdërvjellëta, shumë konflikte të lindura për shkak të akteve që nxjerr ATP-ja, ASHK-ja e të tjera, nuk do të mbarteshin në gjykata. Janë mbi 2000 çështje, të paktën po themi, në Gjykatën e Lartë, konflikte pronësie që vijnë vetëm për shkak të prodhimit të këtyre akteve administrative. A nuk është për të ardhur keq? Ndoshta këto 2000 çështje mund të mos ishin duke pritur prej vitesh atje, sepse ne i dimë të gjitha hallet e gjyqësorit sot, për arsye që ndoshta i takojnë një tryeze tjetër, që të mos ishin këto konflikte, të mos mbarteshin kaq gjatë, deri diku, për subjektet e përfshira, në mënyrë të pashpresë, me zgjidhje që mund të vijnë lehtësisht nga organet ligjzbatuese.

Kështu që, do të doja edhe një herë, t'ju përgëzoja për konkluzionet që keni nxjerrë, pasi unë me të gjitha jam dakord, flas për pjesën e parë, sepse, nëse zgjidhet pjesa e parë, pastaj çështja e dytë është e zgjidhur automatikisht, sepse sa më transparent të jetë një proces, korrupsioni vetvetiu minimizohet, dhe këtë e kemi mësuar nga praktika e vendeve të tjera.

Të gjitha gjetjet çojnë në një drejtim, pra në pjesën e digjitalizimit. Por a përfundon aty gjithçka? A mund të shpresojmë dhe të jemi besimplotë që një proces digjitalizimi si në Kroaci, në Gjermani apo në vende të tjera, do të dihet të zbatohet nga administrata që kemi sot? Sepse u tha këtu edhe nga përfaqësuesit e biznesit që një problem mbartet me vite të tëra për shkak se punonjësi i administratës refuzon të përshtatet me rregullat e reja moderne, më të shpejta, më fleksibël, më transparente e të tjera.

Më duhet të nënvizoj dhe këtë element të fundit që mund të marrim, le të themi, metodat më të mira të inteligjencës artificiale, pse jo, apo digjitalizimin, por nëse nuk ndryshon mentaliteti i atyre që do ta zbatojnë këtë platformë, ne do të mblidhemi sërish tej 2030-ës për të diskutuar po të njëjtat çështje.

Ju faleminderit!

Nadia Rusi – Shumë faleminderit, zonja Vorpsi, për këndvështrimin edhe në kontekstin kushtetues të së drejtës së pronës si një garanci thelbësore për sundimin e ligjit në kuadër të kësaj tryeze.

Nëse ka diskutime të tjera?

Po.

Aida Hoxha – Mirëdita!

Aida Hoxha, përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Faleminderit që noteri është bërë pjesë e kësaj tryeze, duke qenë se për shkak të detyrave funksionale dhe kompetencave që i njeh ligji, ai përbën një garanci të shtuar për mbrojtjen e të drejtave të pronës si një e drejtë kushtetuese. Në fakt, unë do të doja të pohoja me kënaqësi që krahasimisht me një dekadë me parë tashmë është vendosur një standard i ri. Pra, problematikat ne sot i diskutojmë në bazë të këtij standardi të ri të vendosur, jo të atyre të 10 vjetëve më parë. Sot, me ndryshimet e ligjit “Për noterinë”, të vitit 2018, të pasuar me ndryshimet e ligjit “Për kadastrën”, ne flasim dhe punojmë me sisteme që janë avangardë në kuadër dhe krahasimisht edhe me vende të tjera të Ballkanit. Kemi bërë të mundur që këto dy sisteme të ndërveprojnë më së miri, të ketë marrëveshje të herëpashershme të bashkëpunimit. Duket sikur marrëveshjet e bashkëpunimit vijnë si pasojë e problematikave, por nëse punohet, problematikat janë ato që tregojnë se puna vijon dhe ecën.

Kështu që mund të them se ky standard i ri i krijuar bën të mundur që noteri të rimarrë edhe një herë rolin kyç që ka në këto procese, duke e filluar dhe përfunduar transaksionin me pronën në zyrën e noterit, pse jo, gjithmonë duke qenë një sportel virtual, por për qytetarin sportel fizik dhe një urë e mirë komunikimi me kadastrën.

Një gjetje shumë e mirë ishte transparenca. Pra, duket se transparenca në procese, qoftë edhe në procese që pengohen në disa momente, do të ishte një zgjidhje e mirë e problematikave të herëpashershme, sepse transparenca ndihmon në ndërgjegjësimin e qytetarit. Pra, një qytetar, të cilit i kthehet një përgjigje nga kadastra, e përcjellë nga noteri se çështja ka ngelur në këtë proces, ... (*mungesë incizimi*) korrupsioni në mënyrë të dukshme.

Faleminderit!

Nadia Rusi – Shumë faleminderit, zonja Hoxha!

Ilda Zaloshnja – Kam një gjë të vogël ndaj zonjës notere. Unë vij nga bota e *real estate*. Më falni, që e mora fjalën në njëfarë mënyre pa leje, por dua të them thjesht vetëm dy fjalë.

Përveçse nënkryetare e bordit të shoqatës NAREA, unë jam edhe operatore në sektorin e *real estate*-it prej më shumë se 15 vjetësh dhe së bashku me noterët jemi dy hallkat kryesore të trajtimit të transaksioneve imobiliare.

Në fakt, transaksionet imobiliare nuk fillojnë në zyrat e noterëve, por në agjencitë imobiliare, në zyrat e *real estate*-it, të cilat në asnjë rast, akoma deri më sot, nuk kanë absolutisht asnjë lloj akses në regjistrat e pronave apo në sistemet e deritanishme aq pak të digjitalizuara të ASHK-së, kjo ndoshta për arsye se nuk jemi konsideruar faktorë të rëndësishëm në transaksionet

imobiliare. Mund të jemi bërë faktorë që nga viti 2022, kur Ministria e Drejtësisë na licençoi si profesion deri diku i rregulluar. Kjo do të thotë se që të operosh sot në sektorin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme duhet të kesh patjetër një licencë.

Ne kemi shumë vërejtje për mënyrën se si po aplikohet ky ligj, i cili ne, agjencitë e rregullta, vetëm na ka ngarkuar me barrë burokracie dhe kontrollesh, por nuk na ka lehtësuar në asgjë, ose nuk na ka ofruar asnjë mjet për të na ndihmuar që ta bëjmë siç duhet punën tonë, qoftë në mënyrë profesionale ndaj të dyja palëve të klientëve që ne përfaqësojmë, qoftë edhe në eliminimin apo shmangien e korrupsionit që ndodh në transaksionet imobiliare.

Për këtë arsye, meqenëse kam kënaqësinë të jem sot këtu, ftoj drejtoreshën e Përgjithshme të Kadastrës të marrë në konsideratë hapjen e aksesit edhe për ne agjentët e licencuar, *broker*-at, zyrat imobiliare, në sistemin e digjitalizuar të kadastrës, për shkak se deri në momentin që ne shkojmë te zyra e noterit kemi kaluar javë dhe muaj të tërë pune me klientët tanë pa e ditur realisht çfarë prone po trajtojmë dhe në çfarë statusi është ajo pronë. Pra, kjo do të ndihmonte shumë për të kufizuar një sërë problematikash, që çojnë edhe deri tek evazioni fiskal, edhe deri tek korrupsioni i mundshëm i stafeve të zyrave të kadastrës nëpër rrethe.

Nga ana tjetër, një problem tjetër që nuk është cekur ndonjëherë, të paktën me sa kam dëgjuar, lidhet me pallatet e ndërtuara para 10, 15 apo 20 vjetësh, blloqe të tëra lagjesh, siç është, për shembull, zona e Freskut, të cilat kanë ngelur të paregjistruara asnjëherë në hipotekë për shkak se ndërtuesi i atyre pallateve ka shpallur falimentin, ka ikur, ka ndërruar jetë, një mijë e një arsye, dhe banorët e atyre pallateve nuk kanë të drejtën e pronës së tyre, nuk kanë një titull pronësie dhe në këtë drejtim nuk mund as ta tjetërsojnë atë pronë, pra ta shesin, ta dhurojnë, apo të bëjnë ç'të munden me të. Ka ndonjë iniciativë për këtë grupim pronash, që nuk është i vogël në Tiranë?

Faleminderit shumë!

Nadia Rusi – Faleminderit për ndërhyrjen!

Besoj se ka edhe një ndërhyrje të parafundit.

Po, zonja Brati.

Jonida Brati – Dua të përmend diçka, sepse u vu re edhe nga zoti Bregasi. Domethënë, pak a shumë, flitet për të njëjtën problematikë, për dhënien e shërbimit kadastral, duke qenë se ka praktika të ndryshme për raste të ngjashme ose të njëjta të aplikimeve që vetë qytetarët bëjnë nëpërmjet “*e-Albania*”-s apo në zyrat noteriale, të cilin e prekën edhe përfaqësuesit e noterisë.

Më duhet të shpjegoj dhe të sqaroj që ne, përveçse kemi bërë dhe bëjmë trajnime me stafin e ASHK-së, kemi nxjerrë dy akte nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2018, që janë të muajit shtator 2024, të cilat janë enkas për të bërë unifikimin e të gjitha dokumenteve me të cilat qytetarët duhet të aplikojnë, apo edhe kur aplikojnë nëpërmjet noterëve, kur kërkojnë një shërbim kadastral.

Kjo bëhet për të shmangur aplikimet jo të sakta, të cilat marrin kthim-përgjigje nga specialistët e ASHK-së për plotësim dokumentacioni, të cilat rrisin në mënyrë artificiale kërkesat dhe ankesat në sistem. Kjo është për të bërë unifikimin, duke përditësuar dhe saktësuar dokumentacionin, duke bërë të mundur që të aplikohet në mënyrë korrekte dhe nga ana e specialistëve të kthehet një përgjigje shteruese, duke hequr në këtë mënyrë aplikimet që nuk marrin përgjigje, të cilat lënë të kuptohet se ka paafësi nga stafi i ASHK-së apo ka mosdëshirë dhe mungesë vullneti për dhënien e shërbimit.

Gjithashtu, është edhe një udhëzim tjetër për rregullimin e hollësishëm të procedurës për plotësimin e dokumentacionit në aktet kadastrale nga specialistët e ASHK-së, e cila është pjesë e brendshme e sistemit tonë, por automatikisht ndikon në dhënien e shërbimit kadastral dhe plotësimin e çdo përgjigjeje që vjen nga aplikimet.

Me noterët ne kemi marrëveshjen, që zonja e ceku, që në janar të 2020-s. Dy sistemet kanë mundësuar të bëjnë kooperimin midis tyre për të dhënë një shërbim kadastral sa më të shpejtë, sa më real dhe sa më efikas për qytetarët kur aplikojnë nëpërmjet zyrave të noterëve, duke bërë të mundur automatikisht edhe verifikimin e numrave të pasurisë, për të shmangur aplikimet e gabuara. Po ashtu, kemi edhe një VKM të miratuar në tetor të vitit 2024, VKM-në nr.639, për përcaktimin e elementeve formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore, e të tjera. Që këto të kenë mundësi regjistrimi në ASHK, pra të mos hasin vështirësi në regjistrimin e akteve noteriale, të unifikohen, duhet që edhe zyrat noteriale, noterët, vendimet e gjykatave, e të tjera, të kenë elementet formale të duhura që përcakton kjo VKM, po ashtu edhe ligji i noterëve, Kodi Civil dhe çdo akt i legjislacionit në fuqi.

Nadia Rusi – Shumë faleminderit për ndërhyrjen, zonja Brati!

Në përmbyllje të kësaj tryeze konsultimi, do të doja t'ia jepja fjalën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, fjalën e ka Komisioneri për të Drejtën e Informimit, zoti Dervishi.

Besnik Dervishi – Faleminderit!

Do të flas shumë shkurtimisht. Unë kam marrë pjesë në disa tryeza, ashtu si sot, dhe në këtë tryezë të rëndësishme konstatoj se një nga elementet kryesore dhe nga tezat në diskutim është transparenca dhe llogaridhënia. Veçanërisht do të ndalem tek transparenca, që është një nga dy kolonat kryesore të veprimtarisë së institucionit që unë drejtoj. Ne kemi një legjislacion shumë të mirë për sa i përket transparencës, vlerësohet si një nga legjislacionet më të mira, dhe në të përfshihet një instrument ligjor tejet i rëndësishëm, që ne e kemi, dhe që mendoj se mbi të ne do të investojmë shumë, që është programi i transparencës.

Programet e transparencës janë të disponueshme në një format, që, sipas ligjit, miratohet nga komisioneri, por të gjitha institucionet aty janë të detyruara nga ligji t'i ofrojnë publikut në mënyrë proaktive të gjithë informacionin, që nga legjislacioni, aktiviteti, vendimmarrja, pra të gjithë veprimtarinë e autoritetit publik. Ajo që unë do të thosha si gjë që duhet shkuar përtej detyrimeve ligjore, që, për hir të së vërtetës, ne kemi investuar në 10 vjetët e miratimit të këtij ligji, dhe që e konstatoj akoma dhe me më shumë kënaqësi, që mbështetet fort edhe nga ju, ekspertët, por edhe nga të gjithë diskutantët, është kultura e transparencës. Pra, nuk mjafton detyrimi ligjor, por këtë detyrim ligjor ne do ta kthejmë në kulturë të transparencës, sepse kjo pastaj ndikon që ne të kemi një administratë transparente dhe çdo proces transparent, ku edhe ata që nuk e dëshirojnë transparencën vihen përballë një barriere që e frenon transparenca. Në fund të fundit, kjo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në luftën kundër korrupsionit, sepse transparenca nuk është gjë tjetër veçse paradhoma e luftës kundër korrupsionit.

Ju faleminderit!

Nadia Rusi – Shumë faleminderit për ndërhyrjen, zoti Dervishi!

Në mbyllje fjalën e ka zoti Gogu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Lorena Goxhobelli – Do të marr shumë pak kohë, ngaqë e ezaurova kohën time në fillim.

Të falënderoj për ndërhyrjen!

Në fakt, ne i konsiderojmë, siç kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Dhomën e Noterëve. Unë i kam parë si bashkëpunëtorë, si aktorë, si *stakeholders*, të cilët mund të japin një kontribut shumë të mirë në përmirësimin e shërbimit kadastral. Ndaj, do ta vlerësoj, e mbajta shënim sugjerimin tuaj, dhe patjetër që mund ta konsiderojmë në një moment të dytë.

Shumë faleminderit!

Nadia Rusi – Zoti Gogu.

Toni Gogu – Do të flas shumë shkurt, sepse akrepat po arrijnë fundin e orës së dytë të diskutimeve.

Në emër të koleges Gjonaj dhe të kolegut Xhafaj dua të falënderoj të gjithë ekspertët e përfshirë, nga bota akademike, nga grupet e interesit, nga institucionet e pavarura, që për muaj të tërë, pa u lodhur, pa kursyer asgjë, arritën të prodhojnë atë dokument, që besoj se është dokumenti i parë i prodhuar nga shqiptarët të ardhur së bashku në një forum siç është Kuvendi i Shqipërisë! Kështu që, shumë faleminderit!

Unë kam pasur privilegjin që t'i ndjek, të lehtësoj sa të mundem diskutimin që ata kanë pasur dhe prodhimin e atij dokumenti që ju sot e morët, u ballafaquat, dhe sollët të gjitha mendimet tuaja.

Të gjithë ju që nuk patët mundësi ta shprehnit me gojë dhe të diskutonit për ndërhyrjen, edhe në emër të Kryeministrit, i cili u ka kërkuar shërbimeve të Kuvendit që të gjitha diskutimet të përcillen jo vetëm në agjencitë përkatëse, por edhe pranë zyrës së tij, për t'i ndjekur nga afër të gjitha ato sugjerime që ka bërë gjithsecili nga ju, ju lutem, mos ngurroni t'i përcillini, qoftë në faqen që komisioni ka, qoftë edhe pranë ekspertëve drejtpërdrejt.

Nga të gjitha ato problematika dhe sfida që dolën sot, më tërhoqi shumë imazhi ku të gjitha sfidat ishin futur në një unazë, i cili më kujtoi atë elementin e mirënjohur mitologjik të shigjetës së Odisesë, që duhet të kalonte në të gjitha unazat. Pra, mbivendosje, pasaktësi të dhënash, vonesa në ekzekutim vendimesh, vonesa në legalizime.

E gjithë ajo problematikë, pavarësisht lehtësisë që ka sjellë digjitalizimi dhe për të cilin drejtoresha bëri një pasqyrë shumë të saktë, si dhe planeve të integritetit, që këtu dolën dhe komisioneri tha që transparenca është një element tjetër...

Pra, këtu doli fare qartë që ne duhet ta përdorim forcën e teknologjisë, forcën e integritetit, por duhet t'i shndërrojmë ato në një plan veprimi, që besoj se do të jetë puna e këtij komisioni kur të ballafaqohet pasi të miratojë dokumentin dhe të marrë nga ju të gjitha sugjerimet për planin e caktuar të veprimit.

Kështu që, besoj se atë urtësi që ju keni sjellë në atë draft analitik është detyra e Kuvendit të Shqipërisë ta kthejë në një plan veprimi, që të ketë atë precizion për të mbërritur deri në fund, sepse sfidat duhen ballafaquar. Kështu lindin reformat. Kemi ardhur këtu nga reforma në

drejtësi, sepse duhet të ballafaqoheshim me një sfidë shumë të madhe, shumë komplekse, shumë të ndërthurur në zakone shoqërore. E njëjta gjë është edhe kjo. Besoj se integrimi evropian nuk na jep mundësinë që, për shkak të vështirësive dhe kompleksitetit të tyre, ne t'i lëmë mënjanë ato, të bëjmë sikur t'i fshehim, sepse, nga të gjitha shifrat, doli fare qartë se si duhet ndeshur me to, me guxim dhe me shkathhtësi mendimi e veprimi.

Kështu që, shumë faleminderit! Ju lutem, ju që nuk patët mundësi, mos ngurroni të na i përcillni të gjitha ndërhyrjet tuaja!

Ndërkohë, të gjithë profesorëve, ekspertëve, akademikëve, akademikëve që bëjnë dhe praktikë, grupeve të interesit, shoqatave të biznesit, shumë faleminderit që folët troç!

Punë të mbarë dhe vazhdim të mbarë të ditës!

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit